

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hidheni vështrimin tuaj larg në drejtim të së ardhmes, krijoni vizionin tuaj! Leter e Hapur
ADRESA	https://www.leterehapur.com/2022/10/14/hidheni-veshtrimin-tuaj-larg-ne-drejtimit-te-se-ardhmes-krijoni-vizionin-tuaj/
BURIMI	leterehapur.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 15:45:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 tetor 2022, 12:17:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c3fc52583dca8c89da1c10d0e4c334f4edd0de38131e9230be784c094ba992df
TEKSTI	2099336d7790da91e29c56a9662c0bbc3ab024cee0f77e7d392aed6de5416570
PAMJA	901d5f26595954255de741cddb61f18945c9a623209b69ebafedd7e4ddef8358f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	071a4f0f453b6990f61b4bfe82408be295146c9551c18678432595807c864ebc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bb4e79b3ec69077edf87697d0c7be1f8024ce2653cdf443ef98b2b2b16c0a234
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47169057
TRANSAKSIONI	0xc53d1d83eb5113e27101883e7ec1c599aedef807da486e98a6185fca192c6367
IPFS	QmVM2yPqkGdMM4oCMYr6dnZ3RqmeCHegWHRJZJGnzKGCiV



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/071a4f0f453b6990f61b4bfe82408be295146c9551c18678432595807c864ebc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Monitorim

Hidheni vështrimin tuaj larg në drejtim të së ardhmes, krijoni vizionin tuaj!

Nga: Staf | October 14, 2022



Intervistë me Dr. Peter Makiriyado (Ph.D.), Rektori i Nehemiah Gateway University

Përshëndetje profesor Makiriyado. Është një kënaqësi për ne të rinjtë, të jemi përballë jush në këtë intervistë.

Çfarë mund të na thoni për eksperiencat tuaja të mëparshme dhe formimin tuaj akademik?

Atëherë, unë kam dy diploma bachelor në degën e Lidershit Kishtar dhe Studimeve Ndërkulturore, një Master në Administrim Biznesi, një Master of Arts në Teologji dhe një Doktoraturë në Edukim dhe Zhvillim. Për shumë vite kam shërbyer në pozita liderशिpi, së bashku me punën si profesor në edukimin fetar, edukimin teknik dhe biznes. Në Shtetet e Bashkuara kam ndërtuar një organizatë jo fitimprurëse së bashku me një koleg në Zimbabwë, i cili është ende në ndërtim ndërkohë që po flasim.

Duke marrë në konsideratë formimin tuaj akademik dhe punën shumë të vlerësuar, a e zgjodhët ju NGU, apo ju zgjodhën ata ju për të drejtuar?

Pozicioni të cilin unë mbaj aktualisht është vendosur nga Bordi Drejtues i Organizatës. Pasi kisha shërbyer për rreth një vit si Dekan akademik, Bordi vendosi të më emëronte Rektori të Universitetit. Pra me pak fjalë, Nehemiah më zgjodhi mua.

Universiteti juaj ka studentë të huaj, por edhe shqiptarë. Si do ta vlerësonit interesimin e tyre, cilët janë më të përkushtuar në procesin mësimor?

Të mësuarit është në vetvete një proces relativ, pra do të ishte e padrejtë të kategorizonim studentët në këtë mënyrë. Megjithatë, nëse pyetja do të perifrazohej ndryshe mund të arrijmë në përfundimin se për studentët e huaj është përgjithësisht më e lehtë të familjarizohen me orën e mësimit, pasi nuk ekzistojnë barrierat gjuhësore. Pavarësisht kësaj ka shumë studentë shqiptarë për të cilët ky fakt nuk përbën asnjë problem.

Cili është kontributi që universiteti ka dhënë në komunitetin e Pogradecit, duke ditur që është i vetmi në rrethin tonë?

Në NGU ne svnoimë të ofroimë një edukim akademik që konsiston në praktikën e inkuorruar me teorinë. Teoria u

**Dashuri – Respekt-
Mirënjohje (Dita Kombëtare
e Mësuesit)**

Staf - July 2, 2026

mundëson studentevë të krijojnë bazat e nevojshme për të analizuar dhe ndihmuar bizneset e ndryshme në vendin e tyre, por në mënyrë që të bëhet kjo gjë është e rëndësishme ta koordinojmë teorinë me praktikën. Ne jemi të hapur të pranojmë ftesën e çdo biznesi për të ndihmuar në ideimin, ngritjen e biznesit ,por edhe në rimëkëmbjen e tij. Aktualisht, një grup studentësh po punon pranë Kantinës së Verërave 'Caco', duke ndihmuar me strukturimin e saj, për të funksionuar dhe përfutur sa më shumë në tregun konkurrues lokal, por edhe më gjerësisht.

Pse studenti i së ardhmes duhet të zgjedhë NGU?

Një prej arsyeve më të rëndësishme pse NGU duhet të jetë zgjedhja kryesore e studentëve, është kualiteti dhe ekselencia mësimore. Çdo student që del nga bankat e universitetit tonë, e ka merituar diplomën dhe dijet e marra gjatë viteve të shkollës. Është e parashikuar që çdo student të plotësojë 29 module në degën e Ekonomisë dhe Biznesit dhe 19 module në programin Master. Siç e përmenda edhe më lart, ne vlerësojmë jo vetëm teorinë, por edhe anën praktike, për këtë arsye ne u mundësojmë studentëve tanë plot 6 semestra, për të vënë në praktikë njohuritë e marra, duke i mbështetur dhe këshilluar përgjatë gjithë këtij procesi.

Duke ditur se diploma juaj është e akredituar zyrtarisht edhe në SHBA dhe Gjermani, ju mendoji se studentët zgjedhin NGU si një mundësi për të emigruar më pas në këto vende apo zgjedhin standartin mësimor?

Këtu te NGU ne marrim përgjegjësi të plotë për studentët tanë duke iu ofruar atyre edukimin e duhur përmes metodave këshilluese brenda dhe jashtë detyrës të universitetit. Ne krenohemi me çdo arritje të tyre, por dëshira jonë është t'i shohim këta studentë pranë komunitetit të tyre. Pavarësisht rrugëtimit që ata ndjekin në jetë, ne i këshillojmë gjithmonë që të mos reshtin së dhëni kontribut për vendin e tyre, pavarësisht distancës fizike.

A keni menduar të zgjeroni programet tuaja të studimit përveç Ekonomisë dhe Biznesit që ofroni momentalisht?

Po, ne jemi në kërkim të programeve të cilat u përshtaten interesave dhe nevojave të komunitetit tonë. Momentalisht jemi duke punuar me zgjerimin e disa programeve mësimore, si Administrim Biznesi, Punë Sociale, Mikpritja dhe Turizmi.

A keni një mesazh për të rinjtë pogradecarë?

Konsiderojeni veten si qytetarët e së ardhmes, pas disa vitesh ju do të jeni prindërit, qytetarët, liderët e komunitetit, liderët e shoqërisë. Konsiderojeni këtë periudhë si një trajnim dhe parapërgatitje për t'u bërë një kontributor në zhvillimin e gjeneratave të ardhshme. Shijojeni rininë, por mos harroni se ju jeni përgjegjës për të sjellë zhvillimin në komunitetin tuaj. Mos reshtni së mësuari dhe së përgatituri vetveten. Merrni gjithë kohën e nevojshme për të kuptuar se si funksionon shoqëria. Jo vetëm sot për sot, hidheni vështrimin tuaj larg në drejtim të së ardhmes, krijoni vizionin tuaj. Formimi juaj sot përbën një faktor shumë të rëndësishëm të së ardhmes, që ne së bashku po krijojmë. Për një moment mendojeni veten tuaj si një flutur jeta e së cilës kalon në disa faza. Ka një periudhë të caktuar kur është vetëm një larvë si gjithë të tjerat, por mbani mend se kjo është vetëm një periudhë e cila do të kalojë, nuk është e gjithë jeta e fluturës. Një ditë edhe ju do të bëheni flutura, por tani, këtë periudhë të jetës suaj shfrytëzoni për të formuar veten tuaj, personalitetin tuaj. Përpara jush qëndron një jetë e gjatë dhe një e ardhme emocionuese.

Gazetare: Elia Meçi

Korrik – Gusht 2020

Staf

<http://www.leterehapur.com>

PËRGJIGJU

Komento

Emri* Email* Website

☐ Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

POSTO KOMENTIN

TË NGJASHME

MONITORIM

FLAMUJT E EMERGJENCËS
PO VALËVITEN PËR RININË
E SOTME (RISHIKIMI I
LIGJIT PËR RININË IV)

Rinia përfaqëson forcën dinamike dhe produktive të shoqërisë dhe ka një kontribut thelbësor në përparimin dhe prosperitetin e...

MONITORIM

Zë i fuqishëm, por me Mundësi
të Pakta (Rishikimi i Ligjit Për
Rininë III)

Instrumenti i financimit të veprimtarive rinore dhe buxhetet specifike/gjegjëse për rininë janë një çështje që vështirë se po...

MONITORIM

Përkrahja e Rinisë Shqiptare
dhe Tejkallimi i Pengesave
Ligjore (Rishikimi i Ligjit Për
Rininë II)

Vullnetarizmi në vetëvete, si edhe puna vullnetare nga të rinjtë kryesisht, has një tjetër handicap ligjor dhe më...

MONITORIM

Planet Vendore për Rininë

Morëm pjesë në takimin e organizuar nga CRC/ECPAT Shqipëri me mbështetjen financiare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe...

LETËR HAPUR

© 2020 - 2024

• Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i
permbajtjes së kësaj faqeje.

Kategori

MONITORIM	21
FACTO NON VERBA	20
KESHILLI RINOR POGRADEÇ (KRP)	
AKTIVITETE KRP	9 9
FUQIA E LIGJIT	7
PRO-ART	7

Të pëzgjedhura

Dashuri – Respekt- Mirënjohje
(Dita Kombëtare e Mësuesit)

July 2, 2026

SI TË ARRIJMË KRIJIMIN E
LIDERSHIPIT RINOR
(RISHIKIMI I LIGJIT PËR
RININË I)

July 2, 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.